

Statistikat e transportit*

Qershor 2022

Tiranë, më 27 Korrik 2022: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Qershor 2022 është 307,8 mijë tonë, duke u ulur me 25,3 %, krahasuar me Qershor 2021.

Në muajin Qershor 2022, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.718 mijë tonë-kilometër, duke u ulur me 15,0 %, krahasuar me Qershor 2021.

Volumi i mallrave të transportuar me ajër është 163,9 tonë, duke u rritur me 4,1 % në krahasim me Qershor 2021.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

| Periudha | Transporti i mallrave | | |
|-----------------------------|-----------------------|----------------------|------------|
| | Me det / ton | Hekurudhë 000/ton.km | Ajër/ton* |
| Qershor 2021 | 412.040 | 2.021 | 157,4 |
| Qershor 2022 | 307.779 | 1.718 | 163,9 |
| Ndryshimi vjetor (%) | -25,3 | -15,0 | 4,1 |
| Janar-Qershor 2021 | 2.345.300 | 14.952 | 963,8 |
| Janar-Qershor 2022 | 2.079.512 | 10.075 | 981,3 |
| Ndryshimi vjetor (%) | -11,3 | -32,6 | 1,8 |

*Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 2.079,5 mijë tonë, duke u ulur me 11,3 %, krahasuar me gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021

Volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 10.075 mijë tonë-kilometër, duke u ulur me 32,6 %, krahasuar me gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021.

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 981,3 tonë, duke u rritur me 1,8 %, krahasuar me gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021.

Për publikim 27/07/2022

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

| Periudha | Numri i shoqërive ajrore* | Numri i fluturimeve | Numri i mbikalimeve |
|-----------------------------|---------------------------|---------------------|---------------------|
| Qershor 2021 | 17 | 2.396 | 11.086 |
| Qershor 2022 | 19 | 3.732 | 24.548 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 11,8 | 55,8 | 121,4 |
| Janar-Qershor 2021 | 17 | 8.348 | 33.896 |
| Janar-Qershor 2022 | 19 | 16.670 | 85.634 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 11,8 | 99,7 | 152,6 |

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në Qershor 2022, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 103.467 pasagjerë. Krahasuar me Qershor 2021, ky tregues është rritur me 2,5 herë.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 1.221 pasagjerë. Krahasuar me Qershor 2021, ky tregues është ulur me 56,4 %.

Në muajin Qershor 2022, transporti ajror i pasagjerëve zë 82,7 % të transportit gjithsej.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Qershor 2022 është 500.512 pasagjerë, duke u rritur me 91,8 %, krahasuar me Qershor 2021.

Në gjashtëmuajin e parë të vitit 2022, kanë udhëtuar me linjë detare 344.340 pasagjerë, duke u rritur me 75,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 8.847 pasagjerë, duke u rritur me 75,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në gjashtëmuajin e parë të vitit 2022 është 2.098.578 pasagjerë, duke u rritur me 2,8 herë, krahasuar me gjashtëmuajin e parë të vitit 2021.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

| Periudha | Transporti i pasagjerëve | | |
|-----------------------------|--------------------------|--------------|--------------|
| | Me hekurudhë | Me det | Me ajër |
| Qershor 2021 | 2.803 | 40.902 | 260.991 |
| Qershor 2022 | 1.221 | 103.467 | 500.512 |
| Ndryshimi vjetor (%) | -56,4 | 153,0 | 91,8 |
| Janar-Qershor 2021 | 5.042 | 196.023 | 756.637 |
| Janar-Qershor 2022 | 8.847 | 344.340 | 2.098.578 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 75,5 | 75,7 | 177,4 |

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Qershor 2022, volumi i mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 777,9 mijë tonë ku 48,6 % e tyre u transportua me det.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 4.496,9 mijë tonë ku 54,3 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Qershor 2022, volumi i mallrave të eksportuara me tokë zë 62,9 %, me det 37,0 % dhe 0,1 % me hekurudhë. Volumi i mallrave të eksportuara me tokë në Qershor 2022 është ulur me 14,2 %, krahasuar me Qershor 2021.


Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit

| Periudha | Eksport (ton) | | | | |
|-----------------------------|---------------|--------------|--------------|-------------|--------------|
| | Me det | Me hekurudhë | Me tokë | Me ajër | Të tjera |
| Qershor 2021 | 151.106 | 0 | 273.679 | 15 | 110 |
| Qershor 2022 | 138.298 | 336 | 234.712 | 14 | 52 |
| Ndryshimi vjetor (%) | -8,5 | 0,0 | -14,2 | -4,6 | -53,0 |
| Janar-Qershor 2021 | 863.632 | 961 | 1.249.160 | 68 | 813 |
| Janar-Qershor 2022 | 943.056 | 1.104 | 1.113.525 | 119 | 351 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 9,2 | 14,9 | -10,9 | 75,9 | -56,9 |

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të eksportuara me tokë zë 54,1 % dhe me det 45,8 % dhe 0,1 % me hekurudhë. Volumi i mallrave të eksportuara me tokë është ulur me 10,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>

Importet e mallrave

Në Qershor 2022, volumi i mallrave të importuara me det zë 59,2 % dhe me tokë 39,6 %.

Volumi i mallrave të importuara me tokë në Qershor 2022 është ulur me 13,2 %, krahasuar me Qershor 2021.


Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit

| Periodha | Import (ton) | | | | |
|-----------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|-------------|
| | Me det | Me hekurudhë | Me tokë | Me ajër | Të tjera |
| Qershor 2021 | 296.584 | 1.899 | 184.289 | 143 | 3.141 |
| Qershor 2022 | 239.580 | 559 | 159.902 | 116 | 4.371 |
| Ndryshimi vjetor (%) | -19,2 | -70,5 | -13,2 | -19,4 | 39,2 |
| Janar-Qershor 2021 | 1.570.386 | 28.596 | 989.951 | 664 | 10.323 |
| Janar-Qershor 2022 | 1.497.784 | 2.780 | 921.315 | 618 | 16.234 |
| Ndryshimi vjetor (%) | -4,6 | -90,3 | -6,9 | -6,9 | 57,3 |

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, volumi i mallrave të importuara me det zë 61,4 % dhe me tokë 37,8 %. Volumi i mallrave të importuara me tokë është ulur me 6,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti, Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transporti tokësor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues dhe përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi, Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(,,,) mungesë të dhënash